“Askush të mos ndëshkohet me më shumë se dhjetë goditje me kamxhik, përveç kur kemi të bëjmë me ndonjë prej ndëshkimeve të përcaktuara nga Allahu.”

Ebu Burde Ensariu (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut ﷺ duke thënë: “Askush të mos ndëshkohet me më shumë se dhjetë goditje me kamxhik, përveç kur kemi të bëjmë me ndonjë prej ndëshkimeve të përcaktuara nga Allahu.”

[Sahih] [Muttefek alejhi]

Profeti ﷺ në këtë hadith ndaloi që dikush të goditet më shumë se dhjetë herë me kamxhik, përveç në rastet e mëkateve, për të cilat janë përcaktuar dënime. Kjo nuk përfshin dënimet për të cilat Ligjvënësi ka caktuar numër të veçantë goditjesh, ose ndëshkime të përcaktuara. Kuptimi këtu është se rrahja ndëshkuese, si p.sh. në edukimin e gruas apo të fëmijës, nuk duhet të kalojë dhjetë goditje.

http://www.sunnah.global/hadeeth/sq/show/2987